

LIGJ
Nr.7651, datë 21.12.1992

PËR FESTAT ZYRTARE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Janë ditë pushimi ditët e këtyre festave zyrtare:

- a) 1 dhe 2 janari - Viti i RI.
- b) 1 Maji, dita ndërkombëtare e punonjësve.
- c) 28 Nëntori, dita e festës kombëtare.
- ç) Bajrami i Madh, dita e parë.
- d) Bajrami i Vogël, dita e parë.
- dh) Pashkët Ortodokse, dita e parë.
- e) Pashkët Katolike, dita e parë.
- ë) Krishtlindjet, dita e parë.

Kur dita e festave zyrtare të mësipërme është ditë e diel, dita e pushimit do të jetë dita e hënë.

Neni 2

Pranë Këshillit të Ministrave të ngrihet një komision për t'i propozuar parlamentit katalogun e plotë të festave zyrtare dhe jo zyrtare.

Neni 3

Dekreti nr.1600, datë 8.1.1953 "Për festat zyrtare", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shhfuzizohen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekreten nr.401, datë 23.12.1992, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.